



Republika e Kosovës
Republika Kosovo - Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština - Assembly

LEGJISLATURA VIII

Sesioni pranveror

Komisioni për Integritim Evropian

Mbledhja nr. 4

Prishtinë, më 02.06.2021, në orën 9:00

Ndërtesa e Kuvendit, salla N- 204

PROCESVERBAL

Në mbledhje morën pjesë: Rrezarta Krasniqi, Arbëresha Kryeziu-Hyseni, Agon Batusha, Arjeta Fejza, Shqipe Isufi, Driton Hyseni, Ardian Kastrati, Blerta Deliu-Kodra, Time Kadrijaj, Fridon Lala dhe Branislav Nikoliq.

Deputet i interesuar: Alban Bajrami, deputet i LVV.

I ftuar: Besnik Bislimi, zëvendëskryeministër i parë për Integritim Evropian, Zhvillim dhe Dialog me bashkëpunëtorët.

Zyrtarë mbështetës të komisionit: Ahtere Loxha, Adelina Demolli dhe Safet Beqiri.
Pjesëmarrësit e tjerë: Përfaqësuesi nga GLPS, GIZ, OSBE, KDI dhe përfaqësuesit e mediave.

Mbledhjen e kryesoi– Rrezarta Krasniqi, kryetare e komisionit.

Kryetarja e Komisionit, pasi konstatoi se janë plotësuar kushtet për punë, e hapi mbledhjen.

Rendi i ditës:

1. Miratimi i rendit të ditës;
2. Miratimi i procesverbalit të mbledhjes së mbajtur më 26.05.2021;
3. Raportim i z. Besnik Bislimi, zëvendëskryeministër i parë për Integritim Evropian, Zhvillim dhe Dialog;
4. Të ndryshme.

1. Miratimi i rendit të ditës

Rendi i ditës u miratua i pa ndryshuar.

2. Miratimi i procesverbalit të mbledhjes së mbajtur më 26.05.2021

Procesverbali u miratua pa vërejtje.

3. Raportim i z. Besnik Bislimi, zëvendëskryeministër i parë për Integrim Evropian, Zhvillim dhe Dialog;

Kryetarja: Ju kemi ftuar sot që të na njoftoni lidhur me punët dhe objektivat e Qeverisë në procesin e integritimit, me obligimet dhe sfidat me të cilat do të ballafaqoheni, si dhe me mundësin e fillimit të koordinimit në mes institucioneve tona me qëllim të përshpejtimit të përmbushjes së obligimeve në procesin e integritimit evropian për Kosovën.

Sa i përket Komisionit për Integrim Evropian, fokusi i punës tonë do të jetë në tri dimensione, si në atë të: mbikëqyrjes së përmbushjes së obligimeve të cilat dalin nga Raporti për Vendin, mbikëqyrjen e zbatimit të ERA-së dhe PKZMSA-së, në dimensionin legjislativ përfshihet shqyrtimi i të gjitha projektligjeve dhe amendamentet të propozuara nga aspekti i përafritimit me legjislacionin e BE-së; dhe dimensionin i tretë që ka të bëjë me diplomacinë parlamentare: ku përfshihen nismat rajonale dhe ato evropiane.

Sa i përket procesit të liberalizimit të vizave, siç e dimë edhe përkundër faktit që kemi marrë rekomandimin pozitiv nga ana e Komisionit Evropian dhe i njëjti është konfirmuar edhe nga ana e Parlamentit Evropian, ne vazhdojmë të mbesim ende pa të drejtën e lëvizjes së lirë.

Andaj, lidhur me këto procese, dëshirojmë të dimë më shumë, por gjithashtu edhe lidhur me angazhimin e juaj në këtë drejtim.

Besnik Bislimi, zëvendëskryeministër i parë për Integrim Evropian, Zhvillim dhe Dialog me bashkëpunëtorët: Siç e dini fushat të cilat i mbuloj si zëvendëskryeministër, përveç fushës së Integritimit Evropian mbuloj edhe fushën e zhvillimit ekonomik dhe dialogun. Te zhvillimi ekonomik pak është konfuze, sepse duhet t' i monitoroj ministrinë e linjës për të garantuar se programi ekonomik i Qeverisë Kurti duhet të implementohet në tërësi, te fusha e dialogut kam qenë në raportim te Komisioni për Punë të Jashtme, ndërkaq fusha e cila më se shumti merr kohë dhe energji është fusha e Integritimit Evropian, e cila kërkon nga unë bashkëpunimin me gati gjitha institucionet të cilat kanë marrë obligime në përmbushjen e hapave drejt integritimit evropian, sepse gama e aktiviteteve është jashtëzakonisht e gjerë.

Ne fillim të marrjes së qeverisjes, ka qenë 5 vjetori i MSA-së ka qenë periudha kur qeveria e kaluar kishte miratuar prioritetet për fazën e dytë të agjendës së reformave ekonomike dhe kishte mbetur që ne të vazhdojmë me planin e veprimit për ERA 2, ri funksionalizimin e strukturave ndër ministri të cilat kanë marrë përsipër procesin e implementimit të MSA-së dhe përditësimi i PKZMSA-së.

Ndër vendimet e para që ka marrë Qeveria Kurti ka qenë vendimi për funksionalizimin e strukturave që kanë të bëjnë me implementimin e MSA-së dhe ato janë: Këshilli Ndërmintor për Integritim Evropian. Komiteti punues dhe grupet teknike që janë gjashtë sosh për integritim evropian. Gjitha këto grupe janë të mbushura me staf sipas pozitive që mbajnë.

Në ndërkohë kanë vazhduar punimet e nën komiteteve që kanë për detyrë konkretizimin e masave dhe veprimeve. Gjatë draftimeve të prioriteteve dhe veprimeve në kuadër të ERA 2, pikë fillestare ka qenë konstatimi dhe progresi i shënuar në marrëveshjen e parë

ERA 1 dhe në këtë marrëveshje kanë qenë të parapara 22 prioritete të cilat kanë qenë të klasifikuara në 3 shtylla: e para qeverisja e mirë dhe sundimi i ligjit, e dyta konkurrueshmëria dhe klima investive dhe shtylla e tretë punësimi dhe arsimiti.

Pastaj këto 22 prioritete janë detajizuar me 135 veprime të cilat janë dashtë të ndërmerren nga institucionet tona. Është konstatuar se nga 22 prioritetet janë realizuar pak më pak se 50% dhe të njëjtat prioritete janë bartur në ERA 2 dhe është pasuruar me elemente tjera. Disa nga veprimet e dakorduara si në ERA 1 dhe ERA 2 kanë afate kohore të cilat na imponojnë një lloj urgjence sepse përmbushja e këtyre veprimeve ka qenë në mënyrë direkte e lidhur nga përfitimet e BE-së. Ka qenë një dakordim në ERA 1 që deri në fund të vitit 2021 të shkurtohet numri i agjencive që kanë numër me të vogël të punësuarve. Ka pasur ngecje dhe deri më tani nuk e kemi racionalizuar asnjë agjenci, mirëpo ka dakordim që ky proces të shkallëzohet me 4 ligje dhe këtu ka rëndësi kontributi i Kuvendit. Veprime tjera të cilat ndërlidhen nga përfitimet financiare nga BE është çështja e bartjes së institucioneve të AVUK-ut nga niveli lokal në nivelin qendror dhe duhet të kryhet deri në fund të shtatorit dhe të finalizohet në Kuvend amendamenti i Ligjit për pushtetin lokal.

Blerta Deliu: Kam një mori pyetjesh dhe adresime për takimin tonë të parë me z. Bislimi dhe pavarësisht që përfaqësojmë Komision për integritet Evropian duhet të flasim edhe për dialogun Kosovë –Serbi sepse kjo fushë e rëndësishme ndërlidhet me avancimin në agjendën e integritetit evropian.

Po i referohemi draft -raportit të vitit 2020 të hartuar nga raportuesja Viola Von Cramon, raporti është i shoqëruar me një deklaratë shpjeguese ku thuhet që Parlamenti Evropian shpreh keqardhje për progresin e kufizuar në implementimin e agjendës së reformave evropiane, kuptoj që ka qenë viti i vështirë me pandemi, por si do t' i qaset Qeveria këtyre problematikeve?

Po ashtu shqetësuese është shuarja e ministrisë së integritetit evropian, e di që është bërë nga qeveria e kaluar.

Sa keni qenë në opozitë keni qenë kundër MSA-së, kurse tani në Qeveri zotoheni në implementimin e saj dhe në programin qeverisës, tek agjenda evropiane thuhet se Qeveria do të angazhohet në forcimin dhe avancimin e raporteve tona me BE-në, a ka ndryshuar diçka prej atëherë kur keni qenë opozitë?

Në programin qeverisës thuhet po ashtu se Kosova i ka përmbushur kriteret për liberalizim të vizave dhe duke qenë një kohë të gjatë anëtare e këtij komisioni dhe kryetare kam dëgjuar me vëmendje qasjen e qeveris në raport me procesin e liberalizimit të vizave. Jam e tronditur me deklaratën tuaj dhe z. Kurti dhe e kam pasur të pamundur të kuptoj nëse Kosova i ka përmbushur kriteret sepse ju vazhdimisht i ndërroni deklaratat siç ju konvenon.

Po lidhem me vendimin e Qeverisë se dt. 21 maj 2021 për emërimin e anëtarëve të Këshillit shtetëror të cilësisë të Agjencisë Kosovare për akreditim të cilët pastaj do të vijjnë në Kuvend, në mesin e anëtarëve është edhe nipi juaj Gëzim Tosumi.

Në shkurt të vitit 2020, si ministër i financave aso kohe, kur është bërë shkarkimi i bordit të Telekomit, keni thënë se synimi i juaj si ministër dhe Qeveri është ulja e nepotizmit.

Çka ka ndryshuar prej atëherë, a e keni ngritur dorën në mbledhjen e qeverisë për nipin e juaj, a mendoni se një qasje e tillë është konflikt interesi meqë çështja e nepotizmit është e adresuar në takimet tona me përfaqësuesit e BE-së, andaj pasi jeni bartës i një resori të rëndësishëm dua sqarim?

Në programin Qeverisës keni thënë se do të angazhoheni që Kosova të anëtarësohet në organizata ndërkombëtare, para një jave ministri juaj i brendshëm ka thënë se Kosova këtë vit nuk do të aplikojë në asnjë organizatë ndërkombëtare. Andaj na tregoni se çka

po ndodh me këto deklarata të cilat janë të ndryshme nga përfaqësuesit e Qeveris dhe kjo është shqetësuese duke marrë parasysh subjektivitetin ndërkombëtar të Kosovës dhe sovraniteti i jashtëm i cili është i varur kryesisht prej njohjeve dhe ka një rol të rëndësishëm procesi integruet në këtë drejtim.

Si anëtar të komisionit duam të dimë se a jeni për respektimin dhe zbatimin e dokumentit të 4 shtatorit. Në fund, në takimin me z. Palmer dhe z. Lajçak, a keni biseduar për non paperin Gjermano Françez dhe non papera tjerë dhe nga takimet me z. Lajçak ne Bruksel gjatë kësaj jave nuk keni dhënë asnjë hollësi se për çka është diskutuar dhe jam e habitur me këtë qasje jo transparente të Qeverisë në Kuvend.

Zëvendëskryeministri: U ngritën shumë çështje, nuk jam ftuar këtu me i zgjidhur dilemat se çka kuptoni këtu, kur tronditeni kur habiteni, kam ardhur me raportuar për punën time tremujore në fushën e integritimeve evropiane, atë pjesë e zgjidhni me deputetët e Kuvendit, unë ju përgjigjem vetëm ne pyetjet tuaja që kanë lidhje me komisionin.

Blerta Deliu-Kodra: Ju jeni këtu me raportua sepse ne e monitorojmë Qeverinë këto çështje nuk zgjidhen me deputetët.

Zëvendëskryeministri: Unë e kuptova shumë mirë atë që thatë, mos i jepni vetes liri me më sqaruar diçka që veç e kam kuptuar. Te raporti i znj. Viola Cramon i cili konstaton se ka ngecje ne implementimin e reformave, ka qenë edhe konstatim i jonë, që nga 135 veprime 45 nga to nuk janë implementuar dhe rrjedhimisht është vullnet i Qeveris Kurti që ngecjet e ERA 1 të barten në ERA 2. Me dt .13 maj kemi mbajtur një takim të Këshillit Ministror ku i kemi diskutuar obligimet e marra për me pa se a mundemi me i përmbush në afatet kohore. Në atë moment qe dokumenti është i gatshëm, ne do ta miratojmë në Qeveri dhe pastaj do ta përcjellim në Parlament.

Edhe pse Ministria e Integritimeve është shuar, por stafi ka mbet i njëjtë ne kuadër të Zyrës së Kryeministrit dhe është menduar se intervenimi në rrafshin vertikal mundet me e shtuar ritmin e punëve te ministritë e linjës.

Shuarja e MIE dhe kalimi kompetencave te zëvendëskryeministri i parë është parë si shumë pozitive nga ana e partnerëve tanë në BE. Te pyetja e qëndrimit të VV nga e kaluara, unë prapë po them se këtu kam ardhur të raportojë për çështjet e integritimeve, kurse për qëndrimet e VV- së mund t' i diskutoni në seancë plenare. Ajo që po thoni se Qeveria është e mbyllur unë ju them se është shumë transparente, nuk e di ju si deputete e PDK –ës sa herë jeni informuar për hapat që janë ndërmarr në dialog. Unë kam pasur vetëm një takim në Bruksel, ku nuk është folur për dialogun, po ka qenë takim informues dhe dy ditë pas kthimit i kam informuar me letër informuese të gjithë liderët politik, Presidencën, Qeverinë dhe Kryetarin e Komisionit, pre punë të jashtme dhe të njëjtën javë jam ftuar në raportim në Komision për punë të jashtme dhe nuk e di çka mundet me pasur me tepër transparencë në këtë drejtim.

“Te rasti i z. Gëzim Tosumi që ju deklaroni se unë e kam ngritur dorën dhe është konflikt interesi, atëherë a jeni ju dakord që Driton Hyseni, nipi juaj është ulur afër jush në parlament, a jeni dakord që është konflikt interesi?”

Gëzim Tosumin nuk e kam unë nip, e kam dorëzuar ankesën time ndaj “psudoportalit Insajderi” dhe nuk është mirë me ju bashkuar këtij kori me dezinformata, sepse duhet njëherë me u informuar, e pastaj me shtruar pyetjen, prandaj ju thashë për Driton Hysenin, a e keni nip sepse ju keni pasur zero interesim për t' u informuar, ose atëherë ju i keni informuar mediat!

Blerta Deliu-Kodra: Unë këtë lojë e juaj me fjalë për t' i ikur përgjigjes nuk e pranoj, sepse jeni zëvendëskryeministër, nëse thoni se na duhet të dialogojmë me njëri-tjetrin për këto çështje, atëherë pse keni ardhur ju këtu?

Arbëresha Hyseni-Kryeziu; U përmend çështja e ERA 2 ,draftit që po pritet të finalizohet dhe u përmend fakti që ka pas progres të kufizuar, desha të di se ne cilat shtylla ka pasur ngecje me shumë në realizimin e reformave të agjendës evropiane.

Zëvendëskryeministri: Te reforma që është dashtë të barten nga ERA 1,disa prej tyre gjatë janë modifikuar edhe me elemente tjera, te shtylla e parë ka mbetur pa u miratuar një pjesë e legjislacionit te trajtimi i korrupsionit te niveli i lartë, pastaj ka vonesa te konsolidimi i kornizës ligjore që ka të bëjë me reformën e administratës publike, pastaj kemi ngecje te racionalizimi i agjencive..Kemi dakordime të ketë një sërë valësh të reduktimeve, në valën e parë pritet të reduktohen 6 agjenci dhe pastaj 3 valët tjera, dhe kemi dakordim te racionalizimi të përshpejtohet duke i ikur nevojës për çdo val te ketë koncept dokument për secilën vale, por të përdorët koncept dokumenti që është përdorur te vala e parë. Po ashtu ka ende probleme te parandalimi i konflikt interesit, sundimi i ligjit dhe te reforma zgjedhore nuk është përfundua obligimi ne fazën ERA 1 .

Te takimi i parë ndërministror është pare një lloj vullneti i madh nga ana e Kryetarit të parlamentit i cili ka qenë ndër folësit kryesor që të ecet tutje me një në ndërtimin e një kohezioni të partive parlamentare që të finalizohet Ligji për reformat zgjedhore. Te shtylla e dytë po ashtu ka ngecje nga ERA 1 edhe pse numri I prioriteteve ka qenë më i vogël se te shtylla e parë numri i veprimeve ka qenë dukshëm më i madh.

Ka ngecje edhe te dy elemente tjera të cilat janë prioritet edhe te Qeveria Kurti 2 ,rritja e ekonomisë formale dhe intensifikimi i punës për avancimin e agjendës së gjelbër për Ballkanin që është prioritet i BE-së.

Te shtylla që ka të bëjë me punësimin nuk ka pas ngecje në të kaluarën, por ka pas nevojë për pasurim, duke futur brenda edhe shëndetësinë dhe reformat ne arsim, sepse këto lidhen në mënyrë direkte me suksesin në politikat e tregut të punës.

Kryetarja: Në fillim ju pyeta për procesin e liberalizimit te vizave, andaj me intereson të dijë se cila është strategjia juaj me 5 shtetet jo njohëse, a është vetëm dialogu Kosovë-Serbi e vetmja zgjidhje, apo keni në plan edhe diçka tjetër?

Zëvendëskryeministri: Sa i përket liberalizimit të vizave, duhet me e bërë një ndarje me dy elemente , e para liberalizimi i vizave nuk ka të bëjë me vendet mos njohëse, sepse vendet si Greqia dhe Sllovakia nuk kanë kurrfarë problemi ne procesin e liberalizimit , por vendet të cilat janë skeptike dhe e kanë njohur Kosovën kanë problem me faktin se sipas tyre avancimi jonë në luftimin e krimit dhe korrupsionit nuk është i mjaftueshëm dhe duhet te shkohet përtej asaj që reformave ligjore . Mendoj se te një pjesë e vendeve nuk ka të bëjë me Kosovën, por me dëshpërimin e qytetarëve të tyre me përshpejtimin e disa shteteve në liberalizim, e që tani shihen si burime te problemit dhe kanë problem se njëjta do të përsëritet edhe me Kosovën. Problemi pak më i madh është brenga që ka Ministria e Punëve të Brendshme e Francës, ministri Sveçla ka filluar menjëherë kontaktet dhe janë duke i formuar dy grupe të përbashkëta të punës dhe ndoshta përfaqësuesi i Ministrisë së Punëve Të brendshme të Francës do të vijë në Prishtinë për të ndjekur hapat që Ministria e Punëve të Brendshme po ndërmerr ne luftimin e krimit dhe korrupsionit. Po ashtu ende vërejtje ka edhe Holanda dhe Ministria e Punëve të Brendshme ka vu kontakte edhe me Holandën për të parë se si janë të konkretizuara këto brenga dhe për të adresuar bashkërisht në mënyrë që përfaqësuesi

ministrisë së Punëve të Brendshme të Holandës të bindet se Kosova ka realizuar obligimet e marra.

Na është thënë zyrtarisht se brenga ka edhe nga Belgjika dhe e kemi pasur një takim me Kryeministrin Belg dhe ai na është zotuar se vendi i tyre do ta mbështes Kosovën gjatë votimit.

Në të njëjtën kohë Ministria e Punëve të Jashtme është duke punuar në gjetjen dhe mobilizimin e partnerëve që të jenë zëri ynë në Këshillin e Evropës, sepse Kosova nuk mund të marrë pjesë dhe na duhen avokues.

Kemi kontaktuar me Kroacinë dhe me Slloveninë dhe janë zotuar se në momentin kur do të shtrohet kjo temë si pikë e mundshme e Agjendës së Këshillit të Evropës do të jenë avokues për çështjen tonë.

Time Kadrijaj: Propozoj që në takimet e radhës ta kemi një raport të detajuar me shkrim. Në programin e juaj qeverisë e kemi pasur edhe plotësimin e subjektivitetit të Kosovës, zëvendëskryeministër për shkak të ofendimit të nënave gjakovare dhe për shkak të mohimit të masakrës së Reçakut janë shkarkuar ministra, atëherë çka është kjo gjueti e shtrigave nga vetë Qeveria e Kosovës me fyerjet që po bëhen në vazhdimësi, a në këtë formë forcohet subjektiviteti i Kosovës nga deklaratat krerëve të shtetit ?

Andaj z. Kurti nuk duhet të heshtë në raport me këto, por të marrë vendime konkrete dhe të ndal përdhosjen e UÇK-ës, sepse është vlera më sublimë që ka shteti i Kosovës, sepse UÇK nuk ka kryer krime, por ka qenë çlirimtare.

Ndaleni këtë temë sepse është turp dhe nuk forcohet subjektiviteti i Kosovës në këtë formë dhe uluni e punoni dhe Komisionin keni me pasur krah në agjendat evropiane për liberalizim të vizave dhe anëtarësim në organizatat ndërkombëtare, andaj të jemi korrekt edhe komisioni edhe ju në mënyrë që Kosovës t' i japim të gjithë një krah sepse ka nevojë me tepër se kurrë.

Zëvendëskryeministri: Jam i gatshëm t' i përgjigjem çdo kërkesë të Komisionit, pajtohem plotësisht me ju se ne do të kemi sukses në avancimin e proceseve integruese nëse bashkëpunojmë si partnerë dhe mendoj se Komisioni mund të bëjë ndoshta me shumë se Qeveria të vendet mos njohëse për me ndryshua qëndrimin karshi Kosovës. Sa i përket subjektivitetit të Kosovës me çdo veprim tonin jemi duke punuar shumë në këtë drejtim. Nuk janë temë e sotme deklaratat politike të tjerëve por roli im në punën që kam marrë, por ju them me përgjegjësi se kjo Qeveri është më pro UÇK-ës që do ta keni dhe keni pas dhe nuk do të lejoj që UÇK të përdoret për politika ditore.

Driton Hyseni: Unë gjatë raportimit tuaj shoh një gatishmëri të madhe për të shpejtuar progresin në rrugën tonë drejt integriteteve evropiane, desha të ndalem te vizita që ministri i Jashtëm grek do të bëjë në Kosovë!

A e konsideroni se do të jetë një mundësi e mirë që ne të bëjmë hapa konkret me 5 vendet që nuk e kanë njohur Kosovën që të kemi një përsheptim drejt liberalizimit të vizave dhe një mirëkuptim të tyre drejt integriteteve evropiane dhe potencialisht ndonjë njohje nga këto 5 shtete.

Zëvendëskryeministri: Sipas informative që na vijnë nga Brukseli mbështetësi më i madh për liberalizimin e vizave është Greqia, kurse tek procesi i integriteteve dhe avancimi i MSA –së varet nga shtetet mos njohëse. Ajo që kam bërë në rolin tim është të porosisë një analizë të veçorive të secilit shtet mos njohës për të par arsyet dhe qëllimet a janë të njëjta për mosnjohje apo ka specifika dhe pastaj jam munduar në bazë të këtyre

veçorive jam munduar t' i rangosi këto, duke filluar nga vendet që intervenimi nuk ka shpresë në këtë drejtim dhe në vendet ku është më lehtë të punohet.

Ardian Kastrati: Ju e dini se çështja e dialogut nuk është refleksion vetëm mes relacionit Kosovë – Serbi edhe ne edhe ju e dimë që është një ndikim i jashtëzakonshëm në proceset euro integruese, mendoj se dialogu Kosovë-Serbi në fakt është në funksion edhe të disa refleksioneve tjera në nivel Ballkanik, siç janë ato të sigurisë te paqes së gjithmbarshme e për të cilën më së shumti është e interesuar SHBA ,sepse është investitori më i madh i arkitekturës së sigurisë në Ballkan. Ky dialog është i rëndësishëm për shtetin e Kosovës dhe automatikisht e ndërlidh procesin euro integrues të Kosovës, Nuk them që domosdoshmërisht se njohja e Serbisë na siguron ato 5 njohjet për të cilat ju folët me koleg paraprakisht, por në njëfarë mënyre i hap rrugën këtij presioni. Nga lideri juaj i partisë kemi parë disa akte të tradhtisë të këtij 20 vjeçari, e para për Rambujen, pastaj për pakon e Ahtisarit kur ka ftua njerëz ne protesta dhe ka pasur të vdekur dhe tani është ulur ne karrigen e tij, për bashkimin kombëtar që tani u zhduk nga toka, pastaj reciprociteti, tani po thotë Minishengeni po e shtyn kufirin dhe akti i pestë i tradhtisë që po vjen këto ditë.

Tani siç po duket ju mezi po prisni me e fut një parti në zgjerimin e koalicionit për të marr vulën e përgjegjësive në ato oferta që po ju vijnë juvenë tavolinë për dialogun, ose ta dërgoni vendin në zgjedhje .Ky është akti i radhës së tradhtisë nga lideri juaj , ju i keni marrë 50% te votave nga populli dhe po thoni populli jemi ne, andaj po ju pyes çka keni me bërë ju ne negociata me Serbinë dhe ju si koordinator i dialogut, cila ka me qenë qasja e juaj ne raport me SHBA-në dhe BE-në ?

Kishte reagime nga deputetët e vendosjes dhe **Ardian Kastrati** tha qetësohuni dhe mos me ndër preni dhe jepjani nga një paracetamol administrata apo çka pinë këta të Vetëvendosjes. Vazhdoj: Cili ka me qenë qëndrimi juaj, i keni Rezolutat e Parlamentit dhe keni Vendimin e gjykatës ku thuhet se Qeveria ka me e udhëheq dialogun, po flas për ndërlidhjen automatike që euro integrimet kanë me dialogun ,pyetja është kjo, ju çfarë keni me bërë me ofertat që i keni ne tavolinë për dialogun, pse po i ikni atyre, ju keni thënë se keni me i zgjedh problemet, opozita nuk ka rol aty sepse ne i humbëm zgjedhjet ,dialogu lidhet drejtpërdrejt me proceset integruese, sepse nga natyra unikale e BE-së, nuk pranohen dy shtete që nuk e njohin njëra tjetrën ne Union Evropian andaj si zëvendëskryeministër dhe koordinator për dialog ,shpjego ku jeni me dialog

Zëvendëskryeministri: Nuk mundesh së pari me më thënë shpjego se nuk të kam urdhërdhënës , dhe e dyta e filluat me , e dimë edhe ne edhe ju, unë nuk e di çka dini ti po nga informatat që pashë që keni, nuk dini asgjë dhe me këtë qasje e shoh se je konsistent dhe nuk keni ndryshuar, ke mbet ai i njëjti Ardian që ne e kemi larguar prej punës para 10 vjetëve si referent dhe si i tillë që je nuk meriton përgjigje nga unë.

Ardian Kastrati: Nuk do me u përgjigj se nuk ke çka të thuash se je kukull dhe ti e ke largu di kënd prej pune, ti ke bërë kërcim me parashutë ne karrierë .

Reagoi Blerta Deliu, dhe së bashku me Ardian Kastratin e lëshuan mbledhjen.

Kryetarja falënderoj zëvendëskryeministrin për raportimin .

Zëvendës Kryeministri tha se është i gatshëm të raportoj kur do që Komisioni e shoh të nevojshme,

Mbledhja përfundoi në orën 10:20.

E përgatiti:

Stafi mbështetës i komisionit

Kryetare e komisionit,

Rrezarta Krasniqi